



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:182577

Datë: 29.06.2024

Numri i dokumentit: 05876565

2024:182578

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit M.A nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në fsh...., komuna Saraj, i akuzuar për veprën penale, Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.979/24 të dt.28 Qershor 2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 29 Qershor 2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ibadete Hamiti, dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av. F. H, të njëjtë ditë mori, shpalli, dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri I pandehuri M.A nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në fsh. ..., Komuna Saraj, i lindur më dt... nga i ati S... dhe e ëma M..., e gjinisë L..., shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:....

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë me dt. 18 qershor 2024, në afërsi të pikës kufitare, në fsh. Bllacë, që ndanë Republikën e Kosovës me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë ilegale, duke i shfrytëzuar rrugët malore, në vend të pa autorizuar për kalimin e kufirit, ka kaluar kufirin shtetëror, nga Republika e Maqedonisë së Veriut në Republikën e Kosovës, me ç' rast me datë 27 Qershor 2024, rreth orës 22.00, është ndaluar nga Policia e Kosovës, në Ferizaj, rr. "Vëllezërit Gërvalla".

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Prandaj gjykata në baze të nenit 81,82 te KPRK-se, nenit 498,499 dhe 500 te KPPK-se i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurit i bëhet me dije se ka kryer veprën penale të dënueshme dhe poqëse I njejtë sërish kryen veprën të tillë gjykata do t'i shqiptojë sanksion penal më të rreptë.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 30,00 € , ndërsa ne emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit ne shume prej 20.00€, te gjitha keto paguhen pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prerë, në afatin prej 30 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Në bazë të nenit 59 par. 2 nënpar.2.8 dhe nenit 67 par.1 të KPRK-së, të pandehurit përveq gjobës i shqiptohet edhe dënimi plotësues, Dëbimi nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita kur aktgjykimi bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.979/24 të dt.28 Qershor 2024, të pandehurin M.A nga Podujeva, e ka akuzuar për veprën penale, Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në fsh...., komuna Saraj, e ka akuzuar për veprën penale, Kalimi i paaautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 29 Qershor 2024.

Prokurorja e shtetit Ibadete Hamiti në fjalën e saj, me rastin e prezentimit të aktakuës, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I pandehuri në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shprehur pendesë të sinqertë për veprimin e tij dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe i kërkon gjykatës, që duke patur parasysh se arsyeja që kishte dalë në territorin e Rep. së Kosovës në mënyrë ilegale, ishte se, dokumentet e tij i ka patur në burgun e Idrizoves në Shkup, dhe se në këtë mënyrë ka menduar që duke gjetur një punë në Kosovë t'a ndihmojë financiarisht nënën e tij e cila vuna nga një sëmundje e rëndë, me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, andaj edhe i propozon gjykatës që të pranohet pranimi i fajësisë për të pandehurin dhe t'i shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke e patur parasysh rrethanat e propozuara si në aktakuzë dhe poashtu i propozon gjykatës që të njejtit t'i shqiptohet dënimi plotësues, Dëbimi nga territori i Republikës së Kosovës.

Mbrojtësja e te pandehurit ne fjalën e saj deklaroi se e mbështet pranimin e fajësisë të sapo bërë nga i mbrojturi I saj, pranim ky i bërë në përputhje me gjendjen faktike të paraqitur në aktakuzë, në përputhje me dispozitat ligjore dhe atë nenin 242 të KPRK-së , dhe në konsultim të mjaftueshëm me te si mbrojtëse, duke qene i njoftuar për të gjitha pasojat e benifitet juridike. Andaj i propozon gjykatës që të aprovojë këtë pranim fajësije ,dhe me rastin e matjes dhe përcaktimit të dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese: si sjelljen e tij korrekte ,pendimin e tij të thellë, premtimin se në të ardhmen nuk do te përsërisë vepra penale të njëjta apo te ngjashme dhe faktin se vepra e tij nuk ka shkaktuar pasoja të rënda. Poashtu, mbrojtësja ka kërkuar nga Gjykata që, gjate shqiptimit të dënimit të merr parasysh gjendjen e rënduar emocionale të të mbrojturit të saj, për shkaqet e deklaruara gjatë dhënies së deklaratës në polici por edhe sot gjatë kësaj seance gjyqësore . Andaj edhe i propozon gjykatës, që në rast që të mbrojturit të saj, i shqipton dënimin plotësues, Dëbimi i te huajit nga territori i Republikës së Kosoves, kjo të bëhet duke i pershtatur edhe dënueshmërinë e ulet për këtë vepër penale dhe të urdhërojë dëbimin për një kohëzgjatje sa më të shkurtër kohore duke marrë parasysh se i njëjti është në vuajtje të dënimit me burgim në shtetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me më pak se nje vit .

Fjalën e mbrojtësit e ka mbështetur në tërësi edhe I pandehuri.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht , se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me kete gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar ne procedurë, gjykata gjeti se ne veprimet e te pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 te KPRK-se, kështu qe si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza ne tërësi ne shqyrtimin fillestar, duke shprehur keqardhje dhe duke i premtuar gjykatës se në të

ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, bazuar në evidencën penale, i njëjti nuk është recidivist i kësaj vepre penale, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se i njëjti duke qenë i liruar vetëm për vikend nga Burgu e Idrizovës, dhe duke mos patur të drejtë të lëshojë shtetin e Rep. së Maqedonisë së Veriut, ka kaluar lilegalisht në territorin e Rep. së Kosovës, duke shkelur besimin e tyre nga ana e tij si i dënuar, ndërsa rrethanë tjetër rënduese gjykata nuk gjeti, përveq veprimeve të të pandehurit, të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.A i akuzuar për veprën penale, Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, e gjykoi me dënim si ne dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për dëbimin e të pandehurit nga territori i Republikës së Kosovës, u mor në bazë të nenit 59 par. 2 nënpar.2.8 dhe nenit 67 par.1 të KPRK-së, meqë i njëjti, bazuar në shkresat e lëndës, është në vuajtje të dënimit me burgim në shtetin e Rep. së Maqedonisë së Veriut.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2024: 182578 datë 29.06.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.